



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 40, të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt.16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më dt.02.04.2004 merr:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORËS PËR DHËNIEN E TOKËS NDËRTIMORE NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHSHËM PËR NDËRTIM -VENDOSJEN E OBJEKTIT TË PËRKOHSHËM 01.nr.010-2, e dt. 03.01.2002

VIII Mbikëqyrja dhe masat administrative

Neni 54, ndryshohet dhe thotë:

Mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të kësaj Rregulloreje e bënë inspekcioni komunal pranë Drejtoratit të Inspekcionit.

Pronarët e objekteve të përkohëshme janë të obliguar t'i mundësojnë organit nga alinea 1 e këtij neni, kontrollimin e dokumentacionit teknik dhe dokumentacionit tjetër për vendosjen e objektit të përkohëshëm.

Me kryerjen e mbikëqyrjes, Inspektorati komunal me vendim të veçantë, urdhëron:

1. eliminimin e lëshimeve, të konstatuara gjatë vendosjes së objektit,
2. të ndalojë përdorimin e objektit dhe të pajisjeve deri sa të mos menjanohen lëshimet e vërtetuara,
3. të ndalojë vendosjen e objektit pa leje ndërtimi.

Organi kompetent për inspektimet komunale me vendim do të caktojë afatin për eliminimin e të metave të konstatuara.

Neni 55, ndryshohet dhe thotë:

Organi kompetent për inspektimet komunale me vendim do të urdhërojë heqjen apo rrënimin e objektit pa kompenzim (në shpenzimet e pronarit të objektit) në këto raste:

1. nëse objekti është vendosur pa leje,
2. nëse objekti nuk është vendosur sipas kushteve të caktuara urbanistiko-teknike,
3. nëse nuk vepron sipas Vendimit mbi eliminimin e konstatimeve të inspektoratit komunal, brenda afateve të caktuara.

Me vendimin për heqjen e objektit, do të caktohet afati për heqje, do të konstatohet se heqja e objektit bëhet me shpenzimet e pronarit të objektit të përkohëshëm dhe do të kërkohet kthimi i tokës ndërtimore në gjendjen e mëparshme

IX Dispozitat ndëshkimore

Neni 56, ndryshohet dhe thotë:

Me gjobë prej 250 € deri 750 € do të gjobitet personi fizik apo personi përgjegjës i personit juridik, nëse:

- vendos objektin pa lejen e organit komunal kompetent për punë të urbanizmit,
- objekti është vendosur në kundërshtim me kushtet urbanistiko-teknike, të caktuara në bazë të të cilave është lëshuar leja për vendosje e objektit dhe
- nëse nuk vepron sipas vërejtjeve të dhëna me vendimin e organit komunal për punë të inspektimit komunal.

Për kundërvajtjet e shkaktuara, sipas kësaj dispozite, nga personi juridik, do të gjobitet edhe personi juridik me gjobë prej 1000€.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

Nr. _____ dt _____

KRYETAR I KUVENDIT
Ismet Beqiri